



Datë: 11.06.2025
Numër Protokolli: 4246/2025

A.nr.624/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.624/2025, të datës 08.04.2025, të parashtruar nga ankuesja F.Sh, kundër organit të punësimit/Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.06.2025, me shumicë vota, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.624/2025, e datës 08.04.2025, e parashtruar nga ankuesja F.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesja F.Sh (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 08.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me atë së kategorizimi i pozitës së saj nuk është në përputhje me aplikimin e pozitave të njëjtat përgjatë sektorit publikë, duke kërkuar që të bëhet në një kategorizim më të larë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Akademia e Kosovës për Siguri Publikë (*tutje AKSP*), ndërsa kjo e fundit më datë 02.05.2025 ka përcjellë përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesja, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 112/254 të datës 04.04.2012, është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë të llogarive Kombëtare në Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tutje e njëjta fillimisht 22.05.2024, ka parashtruar një kërkesë për shqyrtim tek Agjencia e statistikave të Kosovës nga klasa profesional 2 në klasën profesional 1, e të cilën e ka adresuar tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe nuk ka marr përgjigje.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së kategorizimi i pozitës së saj në profesional 2, nuk është i drejtë, duke pretenduar se duhet të kategorizohet në kategori më të lartë gjegjësisht në klasën profesionale 1.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë nënin 2 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nënin 4 paragrafi 3 ku parashihet se: ” **Neni 2:** 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, **Neni 14:** 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...” referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Marr parasysh akt emërimin e ankueses Kolegji i Këshillit, konstaton se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë e që sipas listës së pagave ankuesja rezulton se paguhet sipas koeficientit 7.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk ka përfunduar klasifikimin e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, rrjedhimisht me nënin 34 të kësaj rregullore përcaktohet se: ***Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje,*** dhe po ashtu, edhe me Vendimin me Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, më pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: ***Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë Klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog,*** ndërsa, më pikën 3 është shfuqizuar pika 3 dhe 4, të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16 shkurt 2023 të Qeverisë së Kosovës, pika këto që i referoheshin detyrimit të Ministrisë së Financave/Thesarit të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për menaxhimin e zyrtareve publik për ekuivalentim të koeficienteve dhe korrigjimeve. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se pa pasur fillimisht klasifikimin e vendeve të punës bazuar në këtë rregullore, vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja, për kategorizimin e pozitës së saj është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e si e tillë e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, si pasojë e përcaktimeve ligjore si më lartë, dhe duke qenë së ASK ende nuk e ka të përfunduar klasifikimin e vendeve të punës, Kolegji duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjore për sigurimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil rikujton institucionin se sipas

përcaktimeve ligjore duke të ndërmerren veprimet në atë mënyrë që të përfundohet klasifikimi i vendeve të punës për zyrtarët publikë të punësuar në këtë institucion në pajtim me kërkesat ligjore.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.624/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.Sh;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në ASK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.